



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr.158/2017

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Rafet Haxhaj kryesues, Adnan Konusheci dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtarit të lartë ligjor Antigona Murati, duke vendosur përkitazi me ankesën e Koalicionit PDK-AAK-NISMA, paraqitur kundër subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje dega në Malisheve, për shkak të vendosjes së tendave reklamuese ne prone publike për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvendin e Republikës së Kosovës, në seancën e panelit të mbajtur me datë 09.06.2017, mori këtë:

VE N D I M

Refuzohet si e pabazuar ankesa Anr.158/2017 e datës 07.06.2017, nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA.

A r s y e t i m

Me datën 07.06.2017, PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Koalicioni PDK-AAK-NISMA me të cilën pretendon se ne Malishevë në afërsi të parkut të qytetit respektivisht në trotuarin e rrugës publike LVV ka vendosur tendën reklamuese me simbole te subjektit politik LVV

Me këtë rast parashtuesi i ankesës thekson se subjekti politik LVV, ka bërë shkeljen e dispozitës së Nenit 4.1 pika b e Rregullës Zgjedhore të KQZ-së 11/2013, neni 3.4 të Rregullës Zgjedhore 13/2014, sepse vendosja e materialit zgjedhor në apo mbi rrugë përbënë veprim të ndaluar për subjektet politike, kandidatët dhe mbështetësit e tyre.

Në kërkesën për përgjigje në ankesë dërguar subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, me datë 07.06.2017, nuk kanë jep ndonjë sqarim lidhur me ankesën. Koalicioni PDK-AAK-NISMA, me datën 08.06.2017, ka paraqitur kërkesë për tërheqje të ankesës, Anr.156/2017, të parashtuar kundër subjektit politik Lëvizjes Vetëvendosje.

PZAP-i, pasi që shqyrtoj ankesën vlerësoi se:

ankesa është e pabazuar

Paneli vlerëson se nga materiali i ofruara si provë nga parashtuesi i ankesës, nuk mund të konstatohet se në trotuarin e rrugës publike nga LVV kanë qenë të vendosur tendën reklamuese me simbole te subjektit politik LVV.

Lidhur me kërkesën e parashtruar nga koalicioni PDK-AAK-NISMA, e datës 08.06.2017, për tërheqjen e ankesës Anr.158/2017 të datës 09.06.2017, e parashtruar ndaj subjektit politik Lëvizja Vetëvendosje, paneli vlerëson se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut dhe se në këtë rast tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ. Në neni 54 par.1 të Ligjit për Procedurën Administrative është parashikuar që “Tërheqja e njërës prej palëve të interesuara nuk sjell ndërprerjen e procedimit administrativ në qoftë se organi kompetent i administratës publike gjykon se vazhdimi i procedimit është në interesin e publikut ose në interesin ligjor të palëve të tjera në procedim”. Paneli nuk e bëri lejinimin e tërheqjes së ankesës pa e vlerësuar nëse në veprimet e subjektit politik LVV, ka elemente të cenimit të interesit të publikut ashtu siç theksohet në ankesë.

Mbi këtë bazë Paneli konsideron se koalicioni në fjalë nuk ka kryer shkelje të nenit 33 pika (b) të LZP-së dhe në kuptim të nenit 118.1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës

Anr.158/2017 më datën 09.06.2017



**Kryesuesi i Panelit
Rafet Haxhaj**

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi nuk lejohet ankesa konform nenit 118 par. 4 të LZP-së.